



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:907443
Datë: 31.07.2024
Numri i dokumentit: 06003308

Ac.nr.10394/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtaret Hidajete Gashi Alaj, kryetare e kolegjit, Faton Ademi dhe Besnik Bislimaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.K.1 dhe ndërhyrësit kryesor A.K.2, nga Fshati ..., Komuna e Ferizaj, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson avokatja Z.Z,nga Ferizaj, kundër të paditurve A.B, F.B.1, F.B.2, F.B.3, K.B, e këta dy të fundit i përfaqëson i padituri F.B.2, që të gjithë nga Fshati Varosh Komuna e Ferizaj, baza juridike, vërtetimi i pronësisë, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurve, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.797/21, i datës 21.09.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa të paditurve A.B, F.B.1, F.B.2, F.B.3, K.B, që të gjithë nga Fshati Varosh Komuna e Ferizaj, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.797/21, i datës 21.09.2021, PRISHET dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.797/21, i datës 21.09.2021, ka vendosur si në vijim:.

“I.APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit A.K.1, dhe ndërhyrësit kryesor A.K.2, vërtetohet se paditës A.K.1, është pronar i ngastrës kadastrale nr. 529-2 Zona kadastrale ... me sipërfaqe prej 2433 m2.

II. Detyrohen të paditurit F.B.1, F.B.2, F.B.3, K.B, që paditësit A.K.1, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ia paguajnë shumën e të hollave prej 1000 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Detyrohet paditësi A.K.1 që kësaj gjykate në emër të shtesës së taksës gjyqësore për padi t'ia paguaj shumën e të hollave prej 34 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

IV. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa e të paditurit F.B.2, me të cilën i ka kërkuar shpenzimet për ardhje në gjykatë qe një vit.”

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit të paraparë ligjor ankesë kanë parashtruar të paditurit për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe Gjykata e Apelit ta prish aktgjykimin e gjykatës së shkallës dhe çështjen ta kthej në rigjykim dhe rivendosje në të njëjtën gjykatë.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar pala paditëse.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurve është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi A.K.1 nga fshati ..., Komuna e Ferizajt ka parashtruar padi pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj, me datë 22.11.2013 me të cilën ka kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë.

Gjykata e shkallës së parë ka marrë aktgjykimin, C.nr.824/2013, i datës 31.07.2017 me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më saktësisht sikurse në dispozitiv të aktgjykimit.

Palët e paditura të pa kënaqura me aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë kanë parashtruar ankesë pranë Gjykatës së Apelit e cila me aktvendimin, Ac.nr.4238/17, i datës 08.04.2021 e ka aprovuar të themeltë ankesën e të paditurve duke e kthyer çështjen në rigjykim dhe vendosje. Pas kthimit në rigjykim, Gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktgjykimin, C.nr.277/2013 i datës 19.02.2015 me të cilën e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht sikurse në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të ankimit ka theksuar se ka vërtetuar gjendjen faktike si vijim: objekti kontesti ndërmjet palëve është ngastra kadastrale 529-2 ZK ..., e cila DGJK evidentohet në emër të F.B.1, F.B.2, F.B.3, K.B, me nga ¼ pjesë ideale si bashkëpronar, e cila në emër të të njëjtëve ka kaluar mbi bazën e aktvendimit për trashëgimi i dt. 27.02.2011 numër T.nr. 122/2011 nga M.B, në emër të njëjtëve. Pjesa kontestuese faktikisht

në terren është e ndarë në dy pjesë në sipërfaqen prej 17 ari 37 metra katror si dhe në sipërfaqen prej 6 ari e 96 metra katror, ose 696 metra katror. Në sipërfaqen prej 1737 metra katror, në anën veri-lindore të saj, është e ndërtuar shtëpia banuese B+P+1 dhe pusi – bunari, në anën perëndimore të sipërfaqes prej 1737 metra katror, për skaj rrugës regjionale Ferizaj –..., është i ndërtuar edhe objekti i pa përfunduar B+P, sipërfaqja prej 696 metra katror, shfrytëzohet si livadh – bari.

Tutje Gjykata ka shtuar se me dëgjimin e të paditurit A.B, në cilësi të palës, si dhe dëshmitares N.Y, ka vërtetuar, se A.B, në vitin 1980/81 pronën kontestuese e ka blerë nga M.B- vëllau i tij, baba i të paditurve F.B.1, F.B.2, F.B.3, K.B, të cilit ia ka paguar në tërësi çmimin e shitblerjes së paluajtshmërisë kontestuese, kurse M.B, tokën kontestuese ia ka dorëzuar në posedim. Tokën kontestuese e ka poseduar A.B, nga viti 1981 deri në vitin 1999 pa u penguar nga askush kurse në vitin 1999 ia ka shitur të njëjtën A.K.1t, edhe atë nga 900 marka për ari, kurse A.K.1, në tërësi ia ka paguar çmimin e shitblerjes së paluajtshmërisë kontestuese, ndersa A.B, A.K.1t, ia ka dorëzuar në posedim paluajtshmerinë, të cilën paditësi A.K.1, e ka poseduar pa u penguar nga askush nga viti 1999 e deri 2017. Kurse i padituri A.B, asnjë herë nuk ka pasur problem me ndokënd për atë tokë. Në tokën kontestuese i padituri A.B, sa e ka pasur në posedim ka mbjellur grurë dhe misër. Kurse faktin se prona kontestuese iu ka shitur A.K.1t, nga A.B, dhe i padituri A.B, e ka poseduar tokën kontestuese pa u penguar nga askush derisa ia ka shitur A.K.1t në atë mënyrë që në të njëjtën ka mbjellur kollomoqë, grurë dhe pasul, Gjykata ka theksuar se ka vërtetuar edhe me dëgjimin e dëshmitarit Jakup Kurtaliqi. Kurse me dëgjimin e dëshmitarit Jakup Kurtaliqi, gjykata po ashtu ka vërtetuar se paditësi A.K.1 në pronën kontestuese ka ndërtuar shtëpi, kurse një ka nisur me ndreq e cila është pa kulm.

Gjykata e shkallës së parë tutje ka shtuar se edhe me dëgjimin e të paditurit F.B.2, në cilësi të palës si dhe pjesërisht nga deklaratat e të paditurit F.B.1, në cilësi të palës ka vërtetuar faktin se i padituri A.B, pronën kontestuese e ka poseduar nga viti 1981 e deri në vitin 1999 dhe të njëjtën në vitin 1999 ia ka shitur A.K.1t, kurse A.K.1 pronën kontestuese e ka në posedim nga viti 1999 e deri në vitin 2017. Kurse gjykata e shkallës së parë ka theksuar se ia ka falur besimin deklaratës së të paditurit A.B, në cilësi të palës dhe deklaratës së dëshmitares N.Y, kur kanë theksuar se A.B, në vitin 1980/81 pronën kontestuese e ka blerë nga M.B – vëllau i tij, babai i të paditurëve F.B.1, F.B.2, F.B.3, K.B, të cilit ia ka paguar në tërësi çmimin e shitblerjes së paluajtshmërisë kurse arsyet që Gjykata ua ka falur besimin deklaratave në fjalë janë: A.B, paluajtshmerinë kontestuese e ka poseduar pa u penguar nga askush nga viti 1981 deri me datën 1999 në atë mënyrë që në të njëjtën kishte mbjellur grurë, misër, pasulë, kurse A.K.1 paluajtshmerinë kontestuese e ka poseduar pa u penguar nga askush nga viti 1999 e deri tani (2017) dhe se në pjesë të asaj toke kishte ndërtuar edhe shtëpi nga ajo që u theksuar më sipër vërtetohet se fakti i posedimit të paluajtshmerinë kontestuese nga i padituri A.B, dhe paditësi A.K.1, ka mundur të jetë i njohur edhe për personat tjerë por edhe për palët e paditura dhe të paditurit, si dhe personat tjerë të interesuar kanë mundur ta kundërshtojnë posedimin nëse i padituri A.B, nuk ka blerë ndonjë pjesë të asaj toke nga babai i të paditurve, F.B.1, F.B.2, F.B.3, K.B, - M.B, të paditurit nuk kanë prezentuar provë për të vërtetuar faktin se e kanë penguar ndonjë herë posedimin e sipër përmendur të ushtruar nga i padituri A.B, nga viti 1981 deri në vitin 1999 si dhe posedimin e sipër përmendur të ushtruar nga paditësi A.K.1, nga viti 1999 deri tani 2017 si

dhe të njëjtit nuk kanë prezantuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se kanë pasur ndonjë pengesë faktike apo juridike për ta kundërshtuar posedimin e tokës kontestuese nga i padituri A.B, si dhe paditësi A.K.1. Mandje të paditurit F.B.1, dhe F.B.2 në deklaratat e tyre të dhëna vërtetojnë faktin se kanë pasur njohuri për posedimin e tokës kontestuese nga i padituri A.B, dhe A.K.1. Kurse të paditurit kanë pranuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit për sipërfaqen prej 20 ari, duke mos specifikuar se në cilën pjesë të ngastrës kontestuese shtrihet kjo sipërfaqe

Gjykata e shkallës së parë ka shtuar se nuk ia ka falur besimin deklaratës së të paditurve F.B.1, F.B.2, F.B.3, K.B, me të cilën e mohojnë (kundërshtojnë) blerjen e sipërfaqes kontestuese prej 433 m², nga i padituri A.B, prej babait të tyre M.B, kurse arsyet që Gjykata nuk ia fali besimin deklaratës në fjalë, janë: A.B, paluajtshmërinë kontestuese e ka poseduar pa u penguar nga askush, nga viti 1981 deri në vitin 1999, në atë mënyrë që në të njëjtën kishte mbjellur grurë, misër pasul, kurse A.K.1, paluajtshmërinë kontestuese e ka poseduar pa u penguar nga askush nga viti 1999 e deri tani (2017) dhe se në pjesë të asaj toke kishte ndërtuar edhe shtëpi nga ajo që u theksua më sipër vërtetohet se fakti i posedimit të paluajtshmërisë kontestuese nga i padituri A.B, dhe paditësi Afet Kuq, ka mundur të jetë i njohur edhe për personat tjerë, por edhe për palët e paditura, dhe të paditurit, si dhe personat tjerë, të interesuar kanë mundur ta kundërshtojnë posedimin nëse i padituri A.B, nuk ka blerë ndonjë pjesë të asaj toke nga abai i të paditurve F.B.1, F.B.2, F.B.3, K.B, - M.B, të paditurit nuk kanë prezantuar provë për të vërtetuar faktin se e kanë penguar ndonjëherë posedimin e sipër përmendur të ushtruar nga i padituri A.B, nga viti 1981 deri në vitin 1999 si dhe posedimin e sipër përmendur të ushtruar nga padituri A.K.1, nga viti 1999 deri tani 2017. , si dhe të njëjtit nuk kanë prezentuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se kanë pasur ndonjë pengesë faktike apo juridike për ta kundërshtuar posedimin e tokës kontestuese, nga i padituri A.B, si dhe paditësi A.K.1. Të paditurit F.B.1, dhe F.B.2, në deklaratat e tyre të dhëna vërtetojnë faktin se kanë pasur njohuri për posedimin e tokës kontestuese nga i padituri A.B dhe A.K.1.

Si përfundim Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar dhe të shpjeguar në arsyetimin e këtij aktgjykimi e veçanërisht gjendjen faktike të shpjeguar si në Pikën III të arsyetimit të këtij aktgjykimi, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar edhe në dispozitën e nenit 28 paragrafi 4, në lidhje me nenin 30 të Ligjit për marrëdhëniet Themelore Pronësore juridike. Si dhe nenin 40 paragrafi të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore.

Vendimi për taksën për padi është bazuar në udhëzimin administrativ për unifikimin e taksave gjyqësore.

Kurse gjykata duke u bazuar në nenin 452 të LPK-së ka vendosur si në pikën IV dhe II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe i ka detyruar të paditurit F.B.1, F.B.2, F.B.3, K.B, që paditësit A.K.1 t'ia paguajnë shpenzimet e procedurës si në vijim: për pjesëmarrjen e përfaqësueses së paditësit në 5 seanca gjyqësore 676 euro, për hartimin e padisë 104 euro, për taksën e paguar për padi 20 euro, për ekspertizë të gjeodezisë 200 euro, gjithsejtë shumën prej 1000 euro.

Gjykata e Apelit e Kosovës nuk e pranon vlerësimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktgjykimi i atakuar me ankesë është

i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë dhe në mënyre të plotë, ku si rezultat i vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike edhe e drejta materiale është zbatuar gabimisht.

Qëndron pretendimi ankimor i të paditurve se aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, ngase dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptimtë dhe në kundërshtim me arsyet e dhëna, përkatësisht nuk përmban arsyeje të mjaftueshme për faktet vendimtare, e si i tillë është i pa qartë, në kundërshtim me vetveten, pastaj i pa përshtatshëm për përmbarrim, por në kundërshtim edhe me arsyet e dhëna në pjesën arsyetuese.

Gjykata e Apelit vlerëson se dispozitivi si i tillë është i pa qëndrueshëm për faktin se A.K.2 në dispozitiv cilësohet si ndërhyrës kryesor mirëpo nga procesverbali i seancës së mbajtur pranë Gjykatës së shkallës së parë me datë 07.09.2021 përfaqësuesja e paditësit dhe e ndërhyrësit ka deklaruar se Avdyl Kuqi me padinë e tij ka përfshirë të gjithë të paditurit dhe kërkon që të vërtetohet se është pronar i ngastrës kadastrale të shënuar në aktgjykimin e datës 31.07.2017.

Neni 266 i LPK-së përcakton se: *“266.1 Personi që tërësisht apo pjesërisht e kërkon sendin apo të drejtën lidhur me të cilën është në zhvillim e sipër procedura midis dy palëve ndërgjyqëse, mundet që në gjykatën e çështjes t’i padisë ato me padinë e tij deri në përfundimin e procedurës me vendim të formës së prerë (ndërhyrja kryesore)”*.

Pra në vështrim të dispozitës së sipërcituar rezulton se ndërhyrësi kryesor e kërkon tërësisht apo pjesërisht sendin apo të drejtën me të cilën është në zhvillim e sipër procedura midis palëve ndërgjyqëse, ndërsa në rastin konkret në këtë çështje juridike kontestimore për Gjykatën e Apelit është tejet e pa qartë se a e kërkon në tërësi të vërtetimin e pronësisë ndërhyrësi kryesor në ngastrën kontestuese, pra të vërtetohet se a është pronar i vetëm apo kërkohet që të vërtetohet se janë bashkëpronar me paditësin.

Për këtë Gjykate është ende e pa qartë cilësia e ndërhyrësit A.K.2, pasi që është e nevojshme që kjo të saktësohet dhe të sqarohet se cila është kërkesa e tij në mënyrë specifike e më pas të vendoset lidhur me cilësinë e tij si ndërhyrës kryesor apo ndërhyrës i thjeshtë ashtu siç e përcaktojnë dispozitat ligjore të LPK-së, pra neni 266 i cituar më lartë si dhe neni 271 që rregullon pozitën e ndërhyrësit të thjeshtë në procedurë.

Gjykata e Apelit në aktvendimin e saj, Ac.nr.4238/17, i datës 08.04.2021 ka dhënë udhëzime tejet të qarta se çfarë veprime duhet ti ndërmarrë Gjykata me rastin e kthimit të çështjes në rigjykim, ndërsa Gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë për bazë as edhe një nga këto udhëzime duke lënë përsëri tepër paqartësi në këtë çështje juridike kontestimore, përkundër faktit se e ka pasur obligim ligjor që t’iu përmbahet vërejtjeve të Gjykatës së Apelit, konform nenit 199 të LPK-së ku përcaktohet se: *“Gjykata e çështjes ka për detyrë që menjëherë pasi t’i arrijë aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë, të caktojë seancën përgatitore apo seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes e cila duhet të mbahet më së voni brenda afatit tridhjetë (30) ditor pas arritjes së aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, si dhe t’i kryejë të gjitha veprimet*

procedurale dhe t'i shqyrtojë të gjitha çështjet kontestuese që i ka ofruar gjykata e shkallës së dytë në aktvendimin e saj."

Gjykata e Apelit vlerëson se përveç të lartcekurave që i referohen si shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore gjenden faktike nuk e ka vërtetuar drejtë dhe mënyrë të plotë.

Si rezultat i shkeljeve të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike ka rezultuar edhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Gjykata të vlerësojë edhe kundërshtimin e palës së paditur në raport me masën e përkohshme ashtu që të mbaj seancë të veçantë në raport me kundërshtimin për masë të përkohshme dhe të vlerësojë pretendimet si të palës paditëse rreth masës po ashtu edhe kundërshtimet e palës së paditur.

Në ri procedure gjykata duhet të eliminojë të metat që e kanë shoqëruar aktgjykimin e atakuar ashtu që fillimisht të zbatoj drejtë dispozitat procedurale, të vlerësojë padinë në kuptim të dispozitave nga neni 99 se a është e qartë dhe e plotë, pra të qartësoj kërkesën e palës paditëse, pastaj duhet të përcaktoj qartë pozitën e A.K.2 si ndërhyrëse kryesore apo e thjeshtë, të vërtetoj saktë se cilën sipërfaqe e ka blerë paditësi, pastaj nga personi që e ka blerë cilën sipërfaqe e ka në posedim, a e ka shfrytëzuar paditësi apo edhe personi që është paraqitur si ndërhyrës kryesor, venin ku gjendet paluajtshmëria, pastaj të vërtetojë saktë dhe drejtë gjendjen faktike, më pastaj pas sqarimit të të gjitha rrethanave dhe vlerësimit të të gjitha provave, duke marrë për bazë dhe vlerësuar edhe të gjitha pretendimet e palës së paditur, të bie vendim të drejtë dhe duke iu përmbajtur elementeve të përcaktuara në nenin 160 paragrafi 3, 4 dhe 5 i LPK-së.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 pika (c) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.10394/2021, me datë 25.07.2024

Kryetare e kolegjit
Hidajete Gashi Alaj, d.v.